



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-271

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË EKSPORTUESE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE UNICREDIT BANK
AUSTRIA AG LIDHUR ME FINANCIMIN E
PROJEKTIT “MODERNIZIMI I SISTEMIT TË EDUKIMIT NË
KOSOVË PËRMES E- EDUKIMIT”**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË
EKSPORTUESE NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
UNICREDIT BANK AUSTRIA AG LIDHUR ME FINANCIMIN E
PROJEKTIT “MODERNIZIMI I SISTEMIT TË EDUKIMIT NË
KOSOVË PËRMES E- EDUKIMIT”**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen për Kredi Eksportuese lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e- Edukimit”, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Austriake Unicredit.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja e Kredisë Eksportuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, lidhur me Financimin e Projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”, e lidhur më 27 shkurt 2014, në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Aneksin Nr. 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për Kredi Eksportuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG lidhur me Financimin e Projektit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-271
17 prill 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI